



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:171254  
Datë: 26.03.2024  
Numri i dokumentit: 05504740

**CA.nr.2779/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti – kryetare e kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesve të masës së të sigurimit paditësit-propozuesit F.SH., L.SH., R.SH., K.SH., R.SH., dhe F.B., që të gjithë nga Podujeva, të cilët me autorizim i përfaqëson SH.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurve-kundërshtarit të sigurimit **1.** Raiffeisen Bank Kosove J.S.C. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson D.G., dhe **2.** MKE KOS SH.P.K. me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga M.K., Drejtor menaxhues, të cilin e përfaqëson me autorizim K.K., avokate nga Prishtina, për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të propozuesve, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, C.nr.1299/2023 të datës 29.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.03.2024, mori këtë :

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e propozuesve të masës së sigurimit F.SH., L.SH., R.SH., K.SH., R.SH., dhe F.B., që të gjithë nga Podujeva, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, C.nr.1299/2023 të datës 29.11.2023, **VËRTETOHET.**

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, C.nr.1299/2023 të datës 29.11.2023, ka vendosur si vijon:

*‘REFUZOHET i pabazuar propozimi i paditësit-propozuesit F.SH., L.SH., R.SH., K.SH., R.SH., dhe F.B., të gjithë nga Podujeva, me të cilin kanë kërkuar që të:*

*1. APROVOHET si i bazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurisë së kërkesëpadisë F.SH., nr. Personal XXXXXX, L.SH., nr. personal XXXXXX, R.SH., nr. personal XXXXXX, K.SH., nr. personal XXXXXXX, R.SH., nr. personal XXXXXX, dhe F.B., nr. personal XXXXXX, të cilët i përfaqëson me autorizim të noterizuar Av. SH.B., nga Prishtina. CAKTOHET masa e sigurisë.*

*2. Ndalohet kundërshtarit të sigurimit dhe personave të tretë, që ta tjetërsojnë, posedojë, fshehtë, ngarkojë apo disponojë me palujtshmërinë e cila evidentohet numër P-71712062-00567-10, Lloji i njësisë Parcelë, në sipërfaqe prej 284 m<sup>2</sup>, Vendi i quajtur Qy....., rr. A.... A....., Zonën Kadastrale Podujevë, shfrytëzim aktual tokë ndërtimore oborr, Toka ndërtimore shtëpi, ndërsa pjesa e pronës 1/1, P71712062—00567-20, lloji i njësisë Parcelë, në sipërfaqe prej 150 m<sup>2</sup>, Vendi i quajtur Q..... rr. A..... A....., zonë kadastrale Podujevë.*

*Në kopje këtij vendimi ti dërgohet Odës së Noterëve të Kosovës dhe Drejtoria për Kadastër në Komunën e Podujevës.”*

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i propozuesve, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika g) dhe n) të LPK-së, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e propozuesit të masës së sigurimit ta aprovoj si të themeltë, ashtu që të ndryshoj aktvendimin e atakuar dhe të caktoj masën e përkohshme të sigurisë, ose ta prish dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ndërsa të detyrohen kundërpropozuesit që t'i mbulojnë shpenzimet e krijuara.

Kundër propozuesi i parë me përgjigje në ankesë, ka propozuar Gjykatës së Apelit që të refuzohet e pathemeltë ankesa e propozuesve të masës së sigurisë, ndërsa të vërtetohet aktvendimi i atakuar.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se :

*-Ankesa e propozuesve të masës së sigurimit, është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës konstatohet se propozuesit e masës së sigurimit, përmes të autorizuarit të tyre, pranë gjykatës së shkallës së parë, kanë parashtruar padi për anulimin e Kontratës së shitblerjes të palujtshmërisë, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, ndaj kundërshtarëve të sigurimit Raiffeisen Bank Kosove J.S.C. me seli në Prishtinë, dhe MKE KOS SH.P.K. me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga M.K., Drejtor menaxhues, me të cilën ka kërkuar që t'iu ndalohet kundërshtarëve të sigurimit, ndërmarrja e çfarëdo veprimi, si shitja apo tjetërsimi, ngarkimi i palujtshmërisë me nr. P-71712062-00567-10 vendi i quajtur " Q.....", në sip. 284 m<sup>2</sup> dhe pjesa e pronës 1/1 me nr.P-71712062-00567-20, vendi i quajtur "Q.....", në

sip. 150 m2, ZK Podujevë, dhe me një kopje të këtij vendimi të njoftohet Oda e Noterëve të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të propozuesve për caktimin e masës së sigurimit, dhe pas marrjes së përgjigjes në propozim të kundërshtarit të parë të sigurimit, ka mbajtur seancën dëgjimore, pas kësaj me aktvendimin C.nr.1299/2023 datë 29.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesve për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur më decidivisht si në aktvendimin e atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, ka gjetur se paditësit-propozuesit nuk i kanë bashkangjitur asnjë provë bindëse materiale për të vërtetuar thëniet e tyre në padi dhe propozim, me të cilat do të vërtetohej kërkesa e tyre dhe fakti se në të ardhmen do të mund t'iu vështirësohej apo pamundësohej realizimi i të drejtës së pretenduar, apo se mund t'iu shkaktohej dëm i pariparueshëm me mos aprovimin e propozimit, se propozuesit e masës nuk e kanë bërë të besueshëm kërkesën se kundërshtarët e sigurimit kanë ndërmarrë çfarëdo veprimi në drejtim të parcelës kontestuese i cili do të çonte në ndryshimin e gjendjes ekzistuese duke e tjetërsuar, ngarkuar me ndonjë barrë apo të ngjashme dhe se do të ekzistoi ndonjë rrezik që pa caktimin e saj pala kundërshtare do ta pamundësonte apo vështirësonte realizimin e kërkesës, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e paditësve-propozuesve, siç kërkohet me dispozitat ligjore të përcaktuara nga nenet 297 dhe 306 të LPK-së, ashtu që pas vlerësimit të propozimit të propozuesve, kundërshtimet e paraqitura dhe të gjitha provat e deponuara nga palët, ka ardhur në përfundim se nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për caktimin e masë së sigurisë siç kërkohet nga nenin 297.1 i Ligjit të Procedurë Kontestimore dhe mbi këtë bazë ka ardhur në përfundim se në këtë rast nuk ka vend për caktimin masës së sigurimit.

Gjykata e Apelit e pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, me dispozitën e nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se *“Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit”*. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadsisë.

Meqenëse, aktvendimi ankimor përmban dispozitiv të kuptueshëm, ndërsa në arsyetim janë paraqit arsye të plota dhe të kuptueshme për të gjitha faktet të cilat kanë qenë me rëndësi për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore, për këtë arsye thëniet e propozuesve të

sigurimit lidhur me atë se aktvendimi ankimor është rrjedhojë e shkeljeve qenësore nga dispozitat e nenit 182 par.1 dhe 182 par.2, pika n) të LPK-së, janë të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar.

Gjykata e Apelit, e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit të propozuar nga propozuesi, sepse me shikim në shkresa të lëndës propozuesit e sigurimit me propozim kanë kërkuar sigurimin e palujtshmërisë me nr. me nr. P-71712062-00567-10 vendi i quajtur "Q.....", në sip 284 m<sup>2</sup> dhe pjesa e pronës 1/1 me nr.P-71712062-00567-20, vendi i quajtur "Q.....", në sip. 150 m<sup>2</sup>, ZK Podujevë, ndërsa që kundërshtarëve të sigurimit t'iu ndalohej bartja, ndërrimi dhe tjetërsimi i saj, e nga ana tjetër është vërtetuar se palujtshmëria e cila kërkohet të sigurohet, ndaj kundërshtarëve të sigurimit, ka kaluar dhe është bartur në pronësi të personit të tretë sipas Kontratës së shitblerjes, e cila kërkohet që të anulohet, dhe e cila është lidhur në mes të kundërshtares së parë të sigurimit dhe kundërshtarit të dytë, në pajtim me nenin 223 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, si për palujtshmerit të cilat janë të regjistruara në hipotekë, e që në rastin konkret palujtshmëria e cila kërkohet të sigurohet me masë, ka qenë e regjistruar pranë ZKK në Podujevë, i cila ka pas titullit përmbartimor të ekzekutueshëm, andaj, vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 297, paragrafi 1, pika a) dhe b) dhe neni 297 paragrafi 2 të LPK, siç përcaktohet se: masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtën subjektive, në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së kështillë palës kundërshtarë do t'i pamundësohet dhe vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe në qoftë se propozuesi i sigurimit sipas vendimit të gjykatës jep garancinë e llojin e masës së caktuar nga gjykata, por që këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Lëshimi i masës së sigurimit pa u plotësuar kushtet e kërkuara në mënyrë strikte sipas dispozitave ligjore të cekura si më lartë, nënkupton pengimin apo kufizimin e palës tjetër në raport me disponimin e pasurisë e cila sipas të gjitha shënimeve dhe raporteve nga shkresat e lëndës del të jetë se kundërshtari i dytë i sigurimit, palujtshmerinë lëndore e ka blerë pas përfundimit të procedurës përkatëse përmbartimore, ndërsa propozuesit pretendimet nga padia për anulimin e kontratës do të mund që ti mbështesin me prova përkatëse lidhur me çështjen kryesore e cila do të zhvillohet në shkallë të parë, mirëpo në këtë fazë të procedurës kërkesëpadia e paditësve nuk mund të sigurohet me masë siguroese, sepse në këtë fazë të procedurës do të mund të afektohen - preken të drejtat pronësore të personave që nuk janë drejtë për drejtë të lidhur me çështjen, por që prona e tyre është objekt i çështjes që kërkohet të sigurohen me masë siguroese.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të merre një vendim ndryshe.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**CA.nr.2779/2024, me datë 22.03.2024**

**Kryetare e kolegjit**  
**Naime Ahmeti, d.v.**